

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

Prishtinë, 01.07.2026

Komiteti Olimpik i Kosovës “KOK” ka statusin e personit juridik, është e regjistruar si organizatë joqeveritare pranë MAP si dhe i takon Lëvizjes Olimpikë duke u angazhuar që të respektojë dispozitat e Kartës Olimpikë me qëllim të promovimit të Lëvizjes Olimpikë, etikës në sport, qeverisjes së mirë si dhe zhvillimit të sportit në përgjithësi. Për arritjen e këtyre synimeve në kuadër të KOK funksionon Akademia Olimpikë e Kosovës “AOK”.

Akademia Olimpik e Kosovës si departament në kuadër të KOK mision ka promovimin e vlerave Olimpikë dhe shpirtin Olimpik si dhe t’i ofrojë standardet më të larta arsimore dhe mundësitë profesionale për komunitetin e sportit në Kosovë duke edukuar breza të profesionistëve në fushën e sportit.

Akademia Olimpikë e Kosovës do të ofron studime të rregullta në programin e studimit të nivelit të pestë sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, themeluar në bazë të ligjit Nr. 03/L-060, datë 07.11.2008 “Për Kualifikimet Kombëtare”.

Në kuadër të planit të operimit të AOK është paraparë programi “Trajneri Sportiv”, i cili është profesion në kuadër të profesioneve të klasifikuara në librin e klasifikimeve të profesioneve në Kosovë. “Trajneri Sportiv” kryen funksione të ndryshme që kanë të bëjnë me trajnim dhe edukim në fushën e sportit. Programi ofron edukimin dhe përgatitjen profesionale të trajnerëve në fushën e sporteve, në drejtimin e menaxhimit individual dhe grupor në një disiplinë sportive.

Bazuar në informatat më lartë rreth KOK, AOK rreth programit të AOK “Trajneri Sportiv”, KOK shpall këtë:

Thirrje publike për aplikim të trajnerëve nga federatat të cilat funksionojnë në Republikën e Kosovës për pjesëmarrje në programin edukues 1 vjeçar të AOK “Trajneri Sportiv”

Komiteti Olimpik i Kosovës bën thirrje publike për aplikim të kandidatëve/trajnerëve në mënyrë individuale apo përmes organizatës së vet sportive që të aplikojnë për pjesëmarrjen në programin “Trajner Sportiv” të KOK, e ku pas përfundimit të programit në fjalë do të marrin Çertifikatë Kombëtare Profesionale (60 ECVET kredi.). Kandidatët të cilët aplikojnë, duhet t’i plotësojnë kriteret e mëposhtme në mënyrë strikte:

1. Pozitat Vendimarrëse

- ☒ Trajnerët që aktualisht mbajnë pozita vendimarrëse/administrative (Kryetar i një organizate sportive) apo Sekretar, nuk kanë të drejtë të aplikojnë për këtë program.

Qëllimi është të sigurohet që trajnerët e përzgjedhur të përqendrohen plotësisht në përgatitjen e sportistëve.

2. Kualifikimet Arsimore dhe Profesionale

- Trajnerët duhet të kenë përfunduar të paktën nivelin e arsimit të mesëm. Përparësi do të kenë ata që posedojnë kualifikime të avancuara ose çertifikime të specializuara në fushën e sportit.

3. Eksperienca e Punës

- Duhet të kenë një minimum prej tre (3) vite eksperiencë në trajnim të nivelit të lartë dhe të kenë trajnuar sportistë që kanë marrë pjesë në gara vendore dhe ndërkombëtare.

4. Pajisja me Njohuri Teknologjike

- Njohuritë bazike për përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve të avancuara për analizën e performancës sportive janë të nevojshme.

5. Përkushtimi për Etikën dhe Integritetin në Sport

- Trajnerët duhet të kenë një histori të pastër në lidhje me etikën dhe integritetin në sport dhe të jenë të angazhuar për të promovuar standarde të larta etike në sport.

Pas përfundimit të programit, kandidati/ja do të aftësohet të kryejë detyrat e punës së **“Trajnerit Sportiv”** si:

1. Përgatitja e procesit stërvitor/trajnues;
2. Realizimi i procesit stërvitor/trajnues;
3. Analizon dhe vlerëson procesin stërvitor/trajnues;
4. Realizon punën specifike në sallën e sportit;
5. Realizon punë specifike në terrenin e hapur sportiv;
6. Realizon punën specifike me persona me aftësi të veçanta;
7. Realizon punën specifike me të gjitha grupmoshat e gjinive të ndryshme.

“Trajneri Sportiv” i gëzon këto kompetenca, për kryerjen e detyrave profesionale në sport:

1. Ofron format metodologjike dhe organizative të punës në sportin përkatës.
2. Ofron metodologjinë e mësimdhënies në sportin përkatës.
3. Bën analizën bazë të procesit stërvitor në sportin përkatës.
4. Bën analizën bazë të teknikës në sportin përkatës.
5. Bën analizën bazë të taktikës në sportin përkatës.
6. Përshkruan strukturën anatomike të trupit të njeriut, funksionet elementare dhe funksionimin e sistemeve lokomotor, kardiovaskular dhe të frymëmarrjes, si bazë për kuptimin e aktivitetit fizik dhe sportiv.
7. Përshkruan proceset fiziologjike në trupin e njeriut, me theks të veçantë në ndikimet e mundshme të aktivitetit kineziologjik mbi to.
8. Përshkruan mekanizmat e lëndimeve në sport dhe zbaton procedurat për parandalimin e tyre.
9. Identifikon dhe përshkruan proceset psikologjike që ndodhin në bazë të formave të ndryshme të sjelljes, si dhe identifikon nevojat dhe rregullat themelore për komunikim të suksesshëm gjatë stërvitjes.
10. Zotëron njohuri bazë nga pedagogjia, duke përshkruar parimet, metodat dhe format e mësimdhënies dhe edukimit, si dhe zbatimin e tyre në procesin e stërvitjes dhe zhvillimit të sportistëve

11. Zotëron njohuri për përpunimin statistikor të të dhënave, metodat e hulumtimit shkencor dhe zbatimin e tyre në fushën e sportit.
12. Zotëron njohuri mbi rolin dhe rëndësinë e biomekanikës në disiplina të ndryshme sportive.
13. Zotëron njohuri për procesin e menaxhimit në sport.
14. Zotëron njohuri për Olimpiadën e Lashtë, vlerat edukative të sportit, olimpizmin, vlerat olimpike, historinë e Lojërave Olimpike, rolin diplomatik të sportit, si dhe misionin dhe vizionin e KOK-ut.
15. Zotëron njohuri mbi teorinë e stërvitjes sportive, parimet e stërvitjes, planifikimin, programimin dhe periodizimin e procesit stërvitor.
16. Përshkruan parimet themelore të të ushqyerit në sport dhe rëndësinë e ushqyerjes, hidratimit dhe rikuperimit për performancën sportive.
17. Kryen matje antropometrike dhe testime bazë të aftësive motorike, funksionale dhe fizike, si dhe interpreton rezultatet për vlerësimin e gjendjes dhe performancës së sportistëve.

Procesi i Aplikimit

Trajnerët e interesuar duhet të dorëzojnë aplikimin e tyre përmes formularit të aplikimit të disponueshëm në faqen zyrtare të KOK. Aplikimet duhet të përfshijnë:

- Kopjet e licencave dhe certifikatave të kualifikimeve;
- Diploma e përfundimit të shkollës së mesme dhe dëftesa e maturës (origjinale ose kopje e vërtetuar tek noteri);
- Certifikata e lindjes;
- Një fotografi me dimension 4x5;
- Raport mjekësor;
- Dëshminë e pagesës së obligimit financiar për regjistrim në Akademinë Olimpike;

Kohëzgjatja e projektit:

- Fillon më 1 Tetor 2026;
- Dita e fundit e dorëzimit të projektit final / Shtator 2027;

Kjo thirrje publike do të jetë e hapur për 45 ditë, respektivisht afati për aplikim është deri më 16 gusht 2026.

Komiteti Olimpik i Kosovës do të shpall listën e kandidatëve të përzgjedhur shtatë (7) ditë pas përfundimit të afatit për aplikim.

Kandidatët të cilët kanë aplikuar në këtë thirrje kanë mundësi që të ankohet brenda afatit prej 10 ditëve që nga marrja e përgjigjes nga KOK.

Aplikimi bëhet përmes emailit: diellza.kelmendi@noc-kos.academy (koordinatore për cilësi në programin “Trajneri Sportiv”) si dhe fizikisht pranë zyreve të KOK (AOK), duke dorëzuar formularin së bashku me dosjen përkatëse siç përcaktohet në këtë thirrje.

Shtojca 1 Informata të përgjithshme

Bashkangjitur me këtë thirrje janë edhe detajet e tjera të programit përfshirë objektivat, aftësimin e kandidatit pas përfundimit të programit, kapacitet tona (infrastruktura, mjetet, burimet njerëzore), struktura e stafit akademik, sigurimi i cilësisë së programit, kriteret shtesë për pranim, lëndët dhe orët e ligjërimit, programi i studimit, 60 kredi ECVET, modulet, planet mësimore, provimet, notat, sanksionet në raste të shkeljeve eventuale nga studentët e deri tek

mënyra e certifikimit.

Vëmendje: Programi “Trajneri Sportiv” është pa pagesë, respektivisht shpenzimet mbulohen nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Pas përfundimit të programit kandidatët/studentët do të marrin **“Çertifikatë Kombëtare Profesionale”**.